

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

AMENDAMENTI 1 PËR KONTRATË TË SHËRBIMEVE

“Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës”

Nr. i prokurimit- 632-20-3720-2-1-5

Nr. i brendshëm-632-20-049-215

E lidhur në Gjakovë, me dt.07.08.2020, në mes të:

Komuna e Gjakovës - Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoritetit Kontraktues)

dhe

N.N.SH. “Korben” (emir i biznesit Roza Komani B.I.) - Gjakovë, me nr.unik 811129726 e përfaqësuar nga z.Ndue Komani (në tekstin e mëtejme Kontraktuesi), në anën tjetër, kanë rënë dakord si më poshtë:

Bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve të KMDK Sh.A. nr.13/2020 të dt.30.07.2020, me të cilin aprovohet Kërkesa e Komunës së Gjakovës, me nr.reference 352/01-15764, të dt.23.07.2020, për bartjen dhe shkarkimin e mbeturinave pa pagesë, në kontratën **“Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës”,Nr. i prokurimit- 632-20-3720-2-1-5, Nr. i brendshëm-632-20-049-215**, e lidhur me dt.22.07.2020, ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit, zëvendësohet / plotësohet si më poshtë:

- **Te Përshkrimi i çmimit:**

Nr. Rendor	Pershkrimi i artikullit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi njësi me tvsh	Totali me tvsh
1	Ngarkimi me eskavator ("bager") i mbeturinave, patrimi i terenit në stacionin transferues të mbeturinave në Gjakovë dhe transporti i tyre deri në deponinë Regjionale Landovicë. Distanca 30 km vajtje dhe 30 km ardhje (total 60km). Llogaritja në ton. Pesha e matur në deponi regjionale duhet të dëshmohej.	ton	25000	9.50	237.500,00
2	Pagesa e taksës për deponimin e mbeturinave në Deponinë Regjionale Landovicë. Llogaritja për ton.	ton	25000	7.30	182.500,00
Gjithsejt parashikimi:					420.000,00

- **Te Kushtet e Veçanta :**

- Fillimi dhe përfundimi i shërbimeve - paragrafi 6.4 :

“Data e Përfundimit : 30 ditë”

- Sigurimi i ekzekutimit –paragrafi 14.1:

“Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit prej **10%** të vlerës së parashikuar për **60 ditë.**”

Ne përputhje me nenin 61, paragrafët 61.22 dhe 61.23, të RRUOPP, te Përshkrimi i çmimit pozicionet e kontratës “Trajtimi i deponisë transfer në Komunën e Gjakovës”,Nr. i prokurimit- 632-20-3720-2-1-5, Nr. i brendshëm-632-20-049-215, e lidhur me dt.22.07.2020,, ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit, ndryshohet me se vijon:

- **Te Përshkrimi i çmimit:**

- Bazuar në Vendimin e Bordit të Drejtorëve të KMDK Sh.A. nr.13/2020, të dt.30.07.2020, sipas të cilit deponimi i mbeturinave në Deponinë Regjionale Landovicë dhe deponitë tjera, që menaxhohen nga KMDK Sh.A, do të bëhet pa pagesë, palët kontraktuese pajtohen që e tërë shuma e pozicionit 2 - **182,500.00€(njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e pesëqind euro)**, do të kalkulohet dhe shpenzohet për pozicionin 1 që d.m.th.:

$$182,500.00€ : 9.50€ = 19\ 210.53\ \text{ton} + 25\ 000\ \text{ton} = 44\ 210.53\ \text{ton}$$

- Në pozicionin 1 në vend të bartjes së 25000 ton mbeturinave, palët kontraktuese pajtohen që të bëhet bartja e 44 210.53 ton mbeturinave dhe shuma e këtij pozicioni nga **237,500.00€ (dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind euro)** rritet në **420,000.00€(katërqind e njëzet mijë euro)**.

- **Te Kushtet e Veçanta :**

-Për paragrafin 14.1 palët kontraktuese pajtohen që afati i përfundimit të kryerjes së shërbimeve, të zgjatet edhe për 15 ditë d.m.th. nga 30 ditë të bëhet 45 ditë .

- Për paragrafin 14.1 palët kontraktuese pajtohen që sigurimi i ekzekutimit prej **10%** të vlerës së kontraktuar **nga 60 ditë të zgjatet në 75 ditë** .

Të gjitha termat dhe kushtet e tjera të kontratës mbeten të pandryshuara. Ky amendament do të jetë pjesë përbërëse e kontratës dhe do të hyjë në fuqi në datën e mëvonshme të nënshkrimit nga palët.

Bërë në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues, dhe një original për Kontraktuesin.

Për Ofruesin e Shërbimeve

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	z.Ndue Komani	Emri:	Komuna e Gjakovës - z.Faton Gutaj
Pozita:	Menaxher	Pozita:	Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.08.2020	Data:	07.08.2020
Vula:		Vula:	



01 352101-15764

23.07.2020

Per/ Za/ To:	z. Abdullah Haxhiu, Kryeshef Ekzekutiv i Kopanise për Menaxhimin e Deponimeve në Kosovë Sh. A (KMDK)
	z. Mentor Hoxhaj, Kryesues i Bordit të Drejtorëve të Kopanise për Menaxhimin e Deponimeve në Kosovë Sh. A SH.A (KMDK)
CC:	- Arkivit
Nga/ Od/ From:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Tema/ Subjekat/ Subject:	Kërkesë për lejimin e bartjes së mbeturinave nga Stacioni Transfer në Gjakovë në deponinë e mbeturinave në Landovicë - dhe vendet tjera ku menagjohen nga KMDK-ja



Të nderuar,


Në Komunën e Gjakovës - përkatësisht në Stacionin Transfer të mbeturinave dhe jashtë Stacionit është krijuar një situatë shumë e rëndë nga mbeturinat e grumbulluara ndër vite.

Me qëllim të eliminimit të kësaj situatë të rënduar nga grumbullimi i mbeturinave dhe nga zjarrvënia dhe parandalimin e ndonjë epidemie në Stacionin Transfer të mbeturinave dhe jashtë tij Komuna e Gjakovës ka filluar të bëjë Sanimin, largimin dhe pastrimit përmes kompanisë së kontraktuar.

Intervenimi nga Komuna e Gjakovës me mbështetje të Ministres së Ekonomisë dhe Ambientit ka qenë i domosdoshëm për shkak të situatës së krijuar dhe mungesës së kapaciteteve logjistike dhe financiare të Kompanisë regjionale të Mbeturinave "Çabradi" SH.A. Gjakovë.

Komuna e Gjakovës kërkon nga Ju si menaxhment i Kopanisë për Menaxhimin e Deponimeve në Kosovë Sh. A që ta lejon kompaninë e kontraktuar nga Komuna e Gjakovës që të bëjë bartjen e mbeturinave nga Stacionin Transfer për shkarkim në Deponinë e Landovicës në Prizren **pa pagesë**, dhe deponit tjera ku menaxhohen nga ana juaj duke i respektua procedurat e parapara të menaxhimit të deponisë.

Me respekt,



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A
Kosovo Landfill Management Company J.S.C.
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lukërishë, 10 000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KMDK. SH.A

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A
KOSOVO LANDFILL MANAGEMENT COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA ZA UPRAVLJANJE DEPONIJAMA NA KOSOVO DO

Nr. 01-14/13

Dt. 03 / 08 / 2020

Prishtinë

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK SH.A)

Nr. 13/2020

Datë: 30/07/2020

Bordi i Drejtorëve të KMDK SH.A në mbledhjen e mbajtur me datën 30.07.2020 nxjerrë këtë:

V E N D I M

1. Autorizohet Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë të gjej mundësinë për realizimin e Kërkesës së Komunës së Gjakovës me nr. reference 352/01-15764 për lejimin e bartjes së mbeturinave pa pagesë, nga Stacioni i Transferit në Gjakovë në Deponinë e Mbeturinave në Landovicë dhe deponitë tjera ku menaxhohen nga KMDK SH.A;
2. Pranimi i mbeturinave do të pranohet deri në atë masë, sa KMDK SH.A do të mund të përballojë në aspektin financiar dhe operativ;
3. Vendimi hyn fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë me dt. 23/07/2020, ka pranuar një kërkesë nga Kryetari i Komunës së Gjakovës për krijimin e mundësisë së bartjes së mbeturinave pa pagesë, nga Stacioni i Transferit në Gjakovë, në Deponinë e Mbeturinave në Landovicë dhe deponitë tjera të menaxhuara nga KMDK. Në kërkesë është theksuar situata emergjente e ndotjes së ambientit, jo vetëm në Gjakovë por edhe më gjerë nga grumbullimi i mbeturinave me vite atje.

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur me datë 24.07.2020 pas trajtimit të kërkesës në fjalë, ka autorizuar Kryesuesin e BD z. Hoxhaj dhe Kryeshëfën e KMDK SH.A z. Haxhiu që, të bëjnë takime me ministrinë dhe komunën në mënyrë që të gjinden modalitete për ta mbështetur Komunën e Gjakovës.

Në mbledhjen e BD të dt .30/07/2020, Kryesuesi z. Hoxhaj dhe Kryeshefi z. Haxhiu informuan anëtarët e Bordit për takimin e mbajtur me përfaqësues të ministrisë, nga ta cilët kanë marrë premtime se KMDK SH.A do përkrahet por kane inkurajuar që, t'i dalim në përkrahje Komunës së Gjakovës për të evituar ndotjen e ambientit dhe situatës emergjente andaj njëzëri u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi u dërgohet:

Arkivit të KMDK – së;

Anëtarëve të Bordit;

NJMNP/MZHE.

Mentor Hoxhaj



Kryesuesi BD të KMDK SH.A